

Detyrë Kursi- Analiza e politikave lidhur me ndryshimet
klimatike.

RASTI I SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS

Përgatiti:

Alba ÇOBA

Erald DALIPI

Fiorela FAKAJ

Kreshnik MEMIA

Uerda SHTISHI

Pranoi:

Dr. Elona POJANI

Tiranë, 13 Janar 2021

Abstrakti

Ndryshimi i klimës paraqet risqe të konsiderueshme si për sistemet e jetesës njerëzore, ashtu dhe për ato natyrore. Çdo ton shtesë i gazrave serë të emetuar nxit më tej politikëbërësit të ndryshojnë dhe vlerësojnë rreziqet e mëdha që kanosen për brezin pasardhës në të ardhmen e afërt. Risqet mjedisore, ekonomike dhe njerëzore të ndryshimit të klimës tregojnë një nevojë të menjëhershme për veprim për të kufizuar madhësinë e ndryshimit të klimës dhe për t'u përgatitur për përshtatjen me ndikimet pasuese.

Shtetet e Bashkuara në mënyrë aktive janë angazhuar në përpjekjet me nivel ndërkombëtar të reagimit ndaj ndryshimeve klimatike për të zvogëluar emetimet e gazeve serë përmes zhvillimit të teknologjisë inovative dhe të pastër, për të rritur aftësitë adaptuese dhe për të çuar përpara dhe vëzhgimet e nevojshme për të kuptuar më mirë shkaqet dhe efektet e ndryshimit të klimës.

Përgjigja ndaj risqeve të ndryshimit të klimës është një nga sfidat më të rëndësishme me të cilat përballen Shtetet e Bashkuara por dhe bota aktualisht. Zgjedhjet e Amerikës lidhur me ndryshimet klimatike përfshijnë gjykime politike dhe vlerësuese nga vendimmarrësit në të gjitha nivelet.

Vetëm strategjitë lidhur me zvogëlimet e emetimeve në SHBA nuk mund të jenë adekuate për të shmangur risqet që kanosen nga ndryshimet e klimës, por përpjekjet e vazhdueshme për uljen e ndotjes në tërësi në SHBA do të rrisin aftësinë për të ndikuar dhe në vendet e tjera që të bëjnë të njëjtën gjë. Adresimi në mënyrë efektive i ndryshimeve klimatike kërkon si kontributin e qeverisjes federale dhe asaj rajonale, ashtu edhe mësimet e nxjerra nga përpjekjet e bëra deri më tani.

Tabela e Përmbajtjes

Abstrakti	2
1. Hyrje: Problematika e përgjithshme dhe fokusi i studimit	1
1.1. Hyrje	1
1.2. Qëllimi dhe objektivat e studimit	2
1.3. Metodologjia dhe strategjia e kërkimit	3
2. Politikat kryesore në nivel qeveritar dhe rëndësia e tyre	4
2.1. Administrata e Klinton (1992-2000)	4
2.2. Administrata e George W. Bush (2001-2009).....	5
2.3. Administrata Obama (2009-2017).....	6
2.4. Administrata e Trump (2017-2020).....	7
3. Politikat në nivel rajonal dhe lokal dhe rëndësia e tyre	8
3.1. Arizona	9
3.2. Kalifornia.....	10
3.3. New York	12
4. Përfundime dhe referenca.....	13
4.1. Përfundime	13
4.2. Bibliografia.....	15

1. Hyrje: Problematika e përgjithshme dhe fokusi i studimit

1.1. Hyrje

Ndryshimi i klimës është një nga çështjet më komplekse me të cilat përballemi sot. Ai përfshin shumë dimensione në secilën fushë, si në shkencë, ekonomi, shoqëri, politikë, çështje morale e etike dhe është një problem global, i ndjerë deri në shkallë lokale, që do të ekzistojë për dekada dhe shekuj në vijim. Dioksidi i karbonit, gazi serrë që bllokoi nxehtësinë që ka nxitur ngrohjen e fundit globale, qëndron në atmosferë për qindra vjet, dhe planeti, veçanërisht oqeani, merr pak kohë për t'iu përgjigjur ngrohjes. Me fjalë të tjera, edhe nëse ndalojmë së emetuarit të gjitha gazrat serë sot, ngrohja globale dhe ndryshimi i klimës do të vazhdojnë të prekin brezat e ardhshëm. Nëse janë të pakontrolluara, ndikimet njerëzore në sistemin klimatik mund të gjenerojnë ndryshime që do të rrezikojnë aspekte të ndryshme të jetës në Tokë. Implikimet e sakta të pretendimeve shkencore në lidhje me ndryshimin e klimës dhe shkalla në të cilën ato paraqesin rreziqe për popullatat e ndryshme, po debatohen intensivisht në shumë nivele në lidhje me politikën. Se si interpretohet rreziku në fund të fundit do të ndikojë në veprimet e ndërmarra. Në këtë punim, ne shqyrtojmë se si konceptohet ndryshimi i klimës dhe rrjedhimisht si është kryer përshtatja nga institucionet përkatëse në SHBA.

Shumica e individëve lidhen me ndryshimin e klimës përmes përvojës personale, njohurive, ekuilibrit të përfitimeve dhe kostove dhe besimit të aktorët e tjerë të shoqërisë. Ne i analizojmë këta faktorë përmes gjetjeve nga sondazhe dhe studime të ndryshme, të cilat nxjerrin në pah veçorinë dhe disa këndvështrime të përbashkëta në një nivel të përgjithësuar. Ndërsa ekziston një nevojë e njohur për t'u përshtatur me ndryshimin e kushteve klimatike, ekziston një kufizim për një përshtatje të tillë. Kufijtë tradicionalisht analizohen si një tërësi e pragjeve të pandryshueshme në parametrat biologjikë, ekonomikë ose teknologjikë.

Ky punim ofron një vlerësim paraprak cilësor, në të cilin theksojmë, (1) efektet anësore të secilës metode të përdorur përshtatjeje, (2) burimet në dispozicion dhe qasjen ndaj tyre, (3) rritjen e fleksibilitetit institucional, përshtatjen, frymën e bashkëpunimit dhe vendimmarrjes, (4) përdorimin e politikave në funksion të kapitalit njerëzor dhe shoqëror, (5) parimet që drejtojnë përgatitjen e planeve të ardhshme të përshtatjes dhe (6) lidhjen e informacionit shkencor në mënyrën më efektive me vendimmarrësit gjatë angazhimit të publikut. Më poshtë do të trajtojmë në mënyrë të veçantë politikën e ndërmarra në luftën me përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, duke theksuar ndikimin negativ që ka pasur sidomos faktori politik, pra përplasja e vazhdueshme midis rrymës republikane dhe asaj demokrate në qasjen e tyre ndaj kësaj çështjeje kaq të ndjeshme për mjedisin, ekonominë, shëndetin e shoqërinë amerikane.

1.2. Qëllimi dhe objektivat e studimit

Klima e botës po ndryshon dhe do të vazhdojë të ndryshojë në shekullin e ardhshëm me ritme që sipas parashikimeve do të jenë të pashembullta në historinë njerëzore. Rreziqet që lidhen me këto ndryshime janë reale dhe shumë të pasigurta.

Përgjatë këtij punimi, jemi përpjekur t'i japim përgjigje pyetjes së ngritur:

“Si kanë ndryshuar politikat e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në harkun kohor 1992-2020 në SHBA?”,

e cila, sipas këndvështrimit tonë, do të shqyrtohet nga mënyra se si është konceptuar dhe saktësisht se si sistemi klimatik i SHBA ka reaguar ndaj këtyre metodave të implementuara përgjatë kohës.

Objektivat, në sajë të të cilave kjo punë do të udhëhiqet janë si më poshtë vijon:

1. Të kuptojmë cilët kanë qenë faktorët e ndryshimit të këtyre politikave.
2. Të analizojmë dhe evidentojmë pikat kyçe dalluese për secilën prej politikave të ndërmarra në nivel federal dhe rajonal.
3. Të sjellim në fokus politikën rajonale me efektivitetin më të mirë.
4. Të përcaktojmë çfarë masash mund të merren që të funksionojë zbatimi i suksesshëm i politikës rajonale.
5. Të sjellim në vëmendje iniciativat që qeverisjet rajonale mund të përdorin për të stimuluar bizneset në implementim të inovacioneve të teknologjisë që i vijnë në ndihmë përshtatjes ndaj ndryshimeve të klimës.
6. Të evidentojmë në bazë të analizës cilat kanë qenë ato politika që kanë gjeneruar efektet më pozitive dhe ato më pak pozitive për mjedisin dhe ekonominë.

Provat shkencore që janë grumbulluar gjatë dekadës së kaluar dokumentojnë se ndikimet e ndryshimit të klimës tashmë janë duke u përjetuar në SH.B.A. Bërësit e politikave dhe menaxherët e burimeve kanë përgatitur mbështetjen e tyre kundrejt zbatimit të planeve të tilla në terren. Në këtë punim ne argumentojmë se ndryshimi i klimës ka sfiduar dhe sfidon Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për të ruajtur qëndrueshmërinë e saj ekonomike, mundësitë që nxisin zhvillimin e mëtejshëm, mirëqenien njerëzore dhe drejtësinë sociale. Për të përballuar këto sfida dhe për të kapur këto mundësi në mënyrë efektive, është e domosdoshme të kuptohen më mirë kapacitetet, mundësitë dhe kufizimet e përshtatjes, proceset shoqërore të adaptimit, qasjet për angazhimin e lojtarëve kritikë dhe publikun e gjerë në debat të informuar, vendimmarrje dhe ndërhyrje të ndërjegjshme në procesin e përshtatjes.

Analiza e përshtatjes pranon se Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk do të jenë të shkëlqyeshëm në përshtatje. Ata ka të ngjarë të shohin nevojën për ndryshim, por mund të kufizohen në aftësinë e tyre për t'u përshtatur ose në të kuptuarit e qëndrueshmërisë dhe drejtimit të ndryshimit.

Ne u bazuam në njohuri nga historia, sociologjia dhe psikologjia e rrezikut, ekonomisë dhe shkencës politike për të zhvilluar katër supozime në lidhje me kufijtë e përshtatjes;

Së pari, çdo kufi i përshtatjes varet nga qëllimet përfundimtare të adaptimit të mbështetur në vlera të ndryshme. Së dyti, përshtatja nuk ka nevojë të kufizohet nga pasiguria rreth parashikimit të ardhshëm të rrezikut. Së treti, faktorët socialë dhe individualë kufizojnë veprimin e adaptimit. Së katërti, nënvlerësimi sistematik i humbjes së vendeve dhe kulturës maskon kufijtë realë, me përvojë, por subjektive të përshtatjes.

Së bashku konkludojmë se këto çështje të vlerave dhe etikës, rrezikut, njohurive dhe kulturës ndërtojnë kufijtë shoqërorë të përshtatjes, por që këto kufij sigurisht janë të ndryshueshëm.

1.3. Metodologjia dhe strategjia e kërkimit

Për realizimin e kësaj teme rolin më të rëndësishëm e kanë patur burimet sekondare të informacionit duke patur parasysh që analiza jonë është kryesisht përshkruese, edhe pse në disa prej rasteve në të cilat politikat mjedisore janë analizuar nga një perspektivë ekonomike, ne diskutojmë ato rezultate të publikuara nga burime serioze dhe zyrtare të informacionit dhe të lidhura ngushtësisht me çështjen e marrë në studim.

Për më tepër, analiza jonë nuk është shteruese. Ndërsa zgjedhja se cilat politika dhe programe për të diskutuar në thellësi, ka qenë në mënyrë të pashmangshme disi arbitrare dhe subjektive duke qenë se kemi zgjedhur pikat më kulmore dhe më interesante për tu diskutuar dhe sjellë në vëmendje. Ne do të tratojmë në mënyrë të përmbledhur momentet më të rëndësishme dhe më të spikatura të ekonomisë dhe mjedisit gjatë dekadave të fundit në SHBA lidhur me çështjet klimatike dhe problematika të shumta të përzgjedhura në mënyrë subjektive dhe analizuar shkurtimisht nga pikpamja ekonomike dhe mjedisore.

Përveç literaturës së larmishme, një rëndësi të veçantë kanë patur edhe raportet e shumta të bazuara mbi këtë problematikë, e cila është kthyer në mjaft shqetësuese për shumë vende të botës jo vetëm për SHBA-të. Për të kuptuar më shumë rreth situatës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës vendosëm që të analizonim këtë temë si nga pikëpamja e politikave kombëtare / federale dhe nga pikëpamja e përpjekjeve rajonale dhe lokale të ndërmarra për të treguar edhe pse nëpërmjet përshkrimit evoluimin e për këtyre politikave dhe shkaqet kryesore të ndryshimeve të ndërmarra.

2. Politikat kryesore në nivel qeveritar dhe rëndësia e tyre

2.1. Administrata e Klinton (1992-2000)

Duke iu referuar rëndësisë së çështjes së ndryshimeve klimatike dhe theksit që i kanë dhënë studiuesit gjatë dekadave të fundit, politikanët ndër vite në Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë kujdesur që t'i japin vëmendjen e duhur në axhendat e tyre politike. Në paragrafët në vijim do të shqyrtojmë shkurtimisht nga prespektiva ekonomike zhvillimet kryesore politikën mjedisore kombëtare gjatë dy mandateve të Administratës Klinton, 1992 deri në 2000. Më poshtë do të analizohet duke e përcaktuar politikën mjedisore gjerësisht për të përfshirë jo vetëm statutet, rregulloret dhe politikat që lidhen me uljen e ndotjes së mjedisit, por edhe çështjet kryesore të menaxhimit të burimeve natyrore.

Nga rishikimi i politikës mjedisore kombëtare gjatë viteve të Administratës së Klinton në paragrafët e mëposhtëm do të fokusohemi në çështjet më kryesore të arritura. Së pari, gjatë dekadës, objektivat mjedisorë u bënë më të rrepta dhe cilësia e mjedisit u përmirësua. Në mandatin e tij të dytë, Klinton propozoi krijimin e Fondit të ri të Partneritetit për Ajër të Pastër, stimuj dhe investime të reja tatimore dhe financim për kërkime mjedisore si për ndryshimet natyrore ashtu edhe për ato të krijuara nga njeriu në klimë. Fondi i Partneritetit të Ajrit të Pastër u propozua për të financuar përpjekjet e shtetit dhe qeverisë lokale për zvogëlimin e emetimeve të gazrave serë në bashkëpunim me Agjencinë e Mbrojtjes së Mjedisit (EPA). Nën këtë fond, 200 milion dollarë u dhanë për të promovuar dhe financuar projekte inovacioni që synojnë të ulin ndotjen e ajrit. Ai gjithashtu mbështeti krijimin e partneriteteve midis qeverive lokale dhe federale, dhe sektorit privat.

Së dyti, përdorimi i analizës kosto-përfitim për vlerësimin e rregullimit mjedisor ishte i diskutueshëm në Administratën e Klintonit, ndërsa efikasiteti ekonomik u shfaq si një qëllim qendror i lëvizjes së reformës rregullatore në Kongres gjatë viteve 1990. Pavarësisht nga një seri urdhrash ekzekutivë mbështetës, efikasiteti ekonomik nuk u pranua si një kriter legjitim për politikën mjedisore gjatë viteve të qeverisjes së Klinton. Provat tregojnë se përfitimet e përgjithshme të rregullimit të ndotjes së ajrit kanë tejkaluar kostot e saj, në përgjithësi duket se ekziston një trend në rënie në përfitimet totale neto të rregulloreve të tilla me kalimin e kohës.

Së treti, efektiviteti i kostos arriti një pozitë shumë më të mirë me politikën mjedisore gjatë viteve 1990, veçanërisht nëpërmjet sistemit të lejeve të tregtueshme. Administrata promovoi efektivitetin e kostos duke mbështetur zbatimin e iniciativave ekzistuese të bazuara në treg, duke përfshirë programin e tregtimit të lejimit të dioksidit të squfurit dhe duke propozuar iniciativa të reja, të ilustruara nga mbështetja e fortë e SHBA për programet e lejeve të tregtueshme për uljen e emetimeve të gazeve serë.

Për ta përmbyllur gjithashtu vlen të theksohet se Klinton në fillim të vitit 1993 kërkoi një taksë për prodhuesit e benzinës, naftës dhe lëndëve djegëse të tjera bazuar në përmbajtjen e karburantit në përputhje me Njësinë Termike Britanike (BTU). Taksa zbatohet gjithashtu për energjinë elektrike të prodhuar nga energjia hidrike dhe bërthamore, por përjashtoi burimet e ripërtëritshme të energjisë si gjeotermale, diellore dhe era. Administrata e Klintonit planifikoi të mblidhte deri në 22.3 miliardë dollarë të ardhura nga taksa deri në vitin 1997. Taksa u kundërshtua nga industria intensive e

energjisë, e cila kishte frikë se rritja e çmimit e shkaktuar nga taksa do t'i bënte produktet e SHBA të padëshirueshme në një nivel ndërkombëtar, dhe kështu nuk u zbatua kurrë plotësisht.

2.2. Administrata e George W. Bush (2001-2009)

Ndryshe nga Klinton, Administrata e George W. Bush njoftoi në Mars të 2001 se nuk do ta zbatonte Protokollin e Kiotos, traktatin ndërkombëtar të nënshkruar në vitin 1997 me qëllim uljen e emetimit të gazrave serë, me pretendimin që ratifikimi i këtij traktati po krijonte pemgesa për SHBA dhe nuk bënte presion të mjaftueshëm për të kufizuar emetimet në kombet në zhvillim. Duke iu referuar politikave të ndërmarra gjatë qeverisjes së Presidentit George W. Bush nga viti 2001-2009, vlen për tu theksuar plani i tij për të ulur intensitetin e gazrave serë me 18 % gjatë 10 viteve. Intensiteti i gazrave serë në mënyrë specifike është raporti i emetimeve të gazeve serë dhe prodhimit ekonomik, që do të thotë se sipas këtij plani, emetimet do të vazhdonin të rriteshin, por me një ritëm më të ngadaltë. Bush deklaroi se ky plan do të parandalonte çlirimin e 500 milion tonë gazra serë, dhe ky objektiv do të arrihej duke siguruar *tax credit* për bizneset që përdorin burime të ripërtëritshme të energjisë.

Administrata e Bush është akuzuar për zbatimin e një fushate dezinformimi të formuluar nga industria, e krijuar për të mashtruar në mënyrë aktive publikun amerikan mbi ngrohjen globale dhe për të parandaluar kufijtë e "ndotësve të klimës". Libri "Hell dhe High Water" pohon se ka pasur një fushatë të paqëndrueshme, të bashkërenduar dhe efektive për të bindur amerikanët se shkencat nuk është provuar, ose se ngrohja globale është rezultat i cikleve natyrore. Gjithashtu punimet e paraqitura në një Kongres Ndërkombëtar Shkencor mbi Ndryshimet Klimatike, të mbajtur në 2009 nën sponsorizimin e Universitetit të Kopenhagës në bashkëpunim me nëntë universitete të tjera në Aleancën Ndërkombëtare të Universiteteve Kërkimore (IARU), pohojnë se skepticizmi ndaj ndryshimeve të klimës i përhapur gjërisht në SHBA "u krijua dhe u mbajt gjallë kryesisht nga një numër i vogël i instituteve konservatore, shpesh me financim të drejtpërdrejtë nga industri që kanë interesa të veçantë për të vonuar ose shmangur rregullimin e emetimeve të gazeve serë". Për më tepër raporte të ndryshme nga Shtëpia e Bardhe dhe jo vetëm kanë dëshmuar se Administrata e Bush u bëri presion shkencëtarëve amerikanë të shtynin studimet e tyre mbi ngrohjen globale dhe ndryshimet e klimës, nga ku një pjesë e madhe e tyre hoqën dorë nga këto punime për të mos sakrifikuar mospublikim e gjetjeve me kryesore nga punë e tyre kërkimore.

Duke iu referuar opinioneve të ambientalistëve, qeverisjen e Bush për tetë vite rradhazi e përshkruajnë si një sulm të bashkërenduar, nga minimi kërkimeve shkencore mbi ndryshimin e klimës, çmontimin e masave mbrojtëse mjedisore deri te mbështetja e tij për minierat dhe interesat e naftës. Ndërsa krahasuar me dy presidentët paraardhës të tij mund të themi se George H. W. Bush, i cili drejtoi SHBA para se të vinte Klinton në pushtet ndërmori masat më efektive ndaj ndryshimeve klimatike, më pas Klinton zgjeroni disa çështje të planit të George H., plani i të cilit mund të konsiderohet më i mirë dhe me bazat më të forta në mbrojtjen e mjedisit. Me hapat e ndërmarra dhe tërheqjen nga disa premtimet në lidhje me këtë çështje plani i George W. Bush nuk bëri më të mirën për mbrojtjen e mjedisit.

2.3. ¹ Administrata Obama (2009-2017)

Ndryshimi i klimës nuk është i dëmshëm vetëm për mjedisin, kërcënon pronën tonë, transportin, komoditetin dhe cilësinë e përgjithshme të jetës. Siç theksohet në raportin e Shtëpisë së Bardhë ndryshimi i klimës është një kërcënim urgjent dhe në rritje për sigurinë kombëtare të SHBA-së, duke kontribuar në rritjen e katastrofave natyrore, flukset e refugjatëve dhe konfliktet mbi burime si ushqimi dhe uji. Ne e dimë se do të ishte e pandërgjegjshme t'i dënonim fëmijët tanë në një planet që është përtej aftësisë së tyre për t'u riparuar. Për fat të mirë, ne kemi mjetet si avantazhin teknologjik dhe imagjinatën shkencore për të filluar punën për rregullimin e tij tani. Përparimet e shpejta në energjinë e pastër, efikasitetin e energjisë dhe teknologjitë e energjisë me karbon të ulët tashmë po krijojnë vende pune, stimulojnë investime dhe nxisin inovacione duke provuar se një mjedis i shëndoshë është themeli më i mirë për një rritje të fortë të qëndrueshme ekonomike. Kalimi në një ekonomi me karbon të ulët është krijimi i industrive të reja dhe zhbllokimi i formave më të pastra të energjisë të përballeshme dhe të besueshme të bërë nga Amerika. Kjo është arsyeja pse më shumë se 1,200 biznese - përfshirë Apple, Microsoft, GM, Nike, Intel dhe Starbucks - kanë deklaruar se "trajtimi i ndryshimit të klimës është një nga mundësitë më të mëdha ekonomike të Amerikës në shekullin 21".

Në Prill 2016, Shtetet e Bashkuara nën Presidentin Barack Obama nënshkruan një marrëveshje ndërkombëtare me 31 faqe, e njohur zakonisht si Marrëveshja e Klimës së Parisit, në Kombet e Bashkuara. Vendet nënshkruese ranë dakord të ulin emetimet e dioksidit të karbonit dhe emetime të ngjashme. Dioksidi i karbonit dhe gazra të ngjashëm bllokojnë nxehtësinë që ndihmon në ngrohjen e planetit dhe disa shkencëtarë supozuar se këto gazra kontribuojnë në ngrohjen globale të shkaktuar nga njeriu në përqendrimet e rritura në atmosferë. Vendet nënshkruese ranë dakord për një qëllim afatgjatë për të mbajtur një rritje në temperaturat mesatare globale nën 2 gradë Celsius (3.7 gradë Fahrenheit) mbi nivelet para-industriale deri në vitin 2100.

Tre shtyllat kryesore mbi të cilat e mbështeti planin e tij të veprimit Administrata e Obamës:

a. Reduktimi i emetimit të karbonit në Shtetet e Bashkuara

Për të ulur emetimet në SHBA, u hapën pesë hapa kryesorë:

1. Shpërndarja e energjisë së pastër duke ulur emetimet nga termocentralet, promovimi i energjisë së rinovueshme dhe investimi në inovacionin e energjisë së pastër.
2. Krijimi i një sistemi modern të transportit duke rritur standardet e efikasitetit të karburantit të automjeteve, veçanërisht për automjetet e rënda, duke inkurajuar biokarburantet përmes Standardit të Klasifikimit të Rinovueshëm.
3. Përmirësimi në efikasitetin e energjisë duke vendosur standarde të reja të eficiencës së energjisë për ndërtesat dhe pajisjet, zvogëlimi i pengesave për investime me eficiencë dhe reduktimi i konsumit të energjisë në ndërtesat tregtare dhe industriale.
4. Zvogëlimi në emetimet e tjera të gazrave serë, posaçërisht hidro-fluorokarbutet dhe metani. Ruajtja e rolit të pyjeve në zbutjen e ndryshimit të klimës.
5. Përmirësimi në efikasitetin e energjisë në ndërtesat dhe operacionet e qeverisë amerikane.

¹ <https://www.eesi.org/papers/view/fact-sheet-timeline-progress-of-president-obama-climate-action-plan>
White House (2015) "President Obama's climate action plan "
https://obamawhitehouse.archives.gov/sites/default/files/docs/cap_progress_report_final_w_cover.pdf

b. Përgatitja për ndikimet e ndryshimit të klimës

Për të përgatitur Shtetet e Bashkuara për t'u përshtatur me ndryshimin e klimës, u përcaktuan tre strategji:

1. Krijimi i një infrastrukture elastike duke hequr pengesat e investimeve, që mbështesin shtetin dhe gatishmërinë lokale, zhvillojnë udhëzime të reja për ndërtesat dhe infrastrukturën tjetër dhe të mësuarit nga përvojat me Superstorm Sandy.
2. Mbrojtja e pasurive kritike, përfshirë termocentralet, pajisjet e shpërndarjes së karburantit, spitalet dhe objektet e tjera të kujdesit shëndetësor; mirëmbajtja e bujqësisë së qëndrueshme; zvogëlimin e zjarreve dhe thatësirave dhe përgatitja për përmytjet.
3. Menaxhimi i ndikimit përmes shkencës duke kuptuar më mirë ndikimin e ndryshimit të klimës, shfrytëzimi i të dhënave për klimën e qeverisë për të nxitur inovacionin dhe krijimi i një "pakete" për të hyrë në burime.

c. Drejtimi i përpjekjeve ndërkombëtare për të zbutur dhe përshtatur ndryshimin e klimës.

Në kushtet e përpjekjeve udhëheqëse ndërkombëtare, Presidenti Obama u angazhua për zgjerimin e bashkëpunimit dypalësh me Kinën, Indinë dhe Brazilin.

2.4. ²Administrata e Trump (2017-2020)

Tashmë për SHBA-të janë bërë të njohura qëndrimet krejtësisht të ndryshme të demokratëve dhe republikanëve përkundrejt çështjes së ndryshimeve klimatike. Administrata Trump pas ardhjes së saj në pushtet eliminoi si fillim një ndër rregullat e epokës Obama për impiantet e qymyrit për të kufizuar emetimet e tyre të mërkurit dhe ndotësve të tjerë. Nëpërmjet programit të tij ai ndryshoi dhe eliminoi, më shumë rregullore të epokës Obama, këtë herë standardet e efikasitetit të karburantit, u ndryshuan rëndë, duke lejuar prodhuesit e makinave të ecnin drejt makinave me efikasitet të karburantit më ngadalë, si dhe duke ulur qëllimin e përgjithshëm atë të uljes së emetimit të dioksidit të karbonit. Administrata e Trump ka shfuqizuar ose ka rikthyer 100 rregullore mjedisore që nga ardhja në fuqi në 2017. Administrata ka markuar iniciativën e saj si një mënyrë për të hequr pengesat për biznesin, veçanërisht industrinë e karburanteve fosile.

Administrata e Trump filloi të mos miratonte dhe gjithashtu eliminoi një pjesë të madhe të rregulloreve të miratuara nga Obama lidhur me ndotjen e ajrit dhe emetimet, apo edhe e çdo kategorie të rregullimit të mjedisit. Veçanërisht, administrata eliminoi kërkesat për kompanitë e naftës dhe gazit për të raportuar emetimet e metanit dhe për të llogaritur "koston sociale të karbonit", një rregull i epokës së Obamës për të vlerësuar përfitimet afatgjata të reduktimit të emisioneve të dioksidit të karbonit.

² https://ballotpedia.org/Trump_administration_officials_on_energy_and_the_environment

Rregulloret që kanë të bëjnë me shpimin dhe nxjerrjen janë kategoria e dytë me më shumë kthime mbrapa. Disa ndryshime të rëndësishme në rregulloret mjedisore që administrata Trump ka arritur përfshijnë miratimin e tubacionit Dakota Access, i cili shkon më pak se një milje nga rezervimi i Standing Rock Sioux, prerja e kufirit të dy monumenteve kombëtare në Utah, shfuqizimin e rregulloreve të ndotjes së ujit për ndarjen në tokat federale dhe rezervatore, gjithashtu edhe anulimin e rregulloreve të EPA-s që do të detyronin minierat të provonin se mund të paguanin për të pastruar ndotjen që po shkaktojnë.

Dhe më konkretisht, më 1 qershor 2017, Presidenti Donald Trump njoftoi se Shtetet e Bashkuara do të tërhiqen nga Marrëveshja e Klimës në Paris. Trump argumentoi se marrëveshja ishte e padrejtë ndaj Shteteve të Bashkuara, do të ulte vendet e punës dhe do të kishte pak efekt në temperaturat globale nëse zbatohet plotësisht. Më 28 Mars 2017, Presidenti Trump nënshkroi një urdhër ekzekutiv që drejton Agjencinë e Mbrojtjes së Mjedisit (EPA) të konsiderojë shfuqizimin zyrtar të Planit të Energjisë së Pastër, një rregull federal i finalizuar në 2015 që urdhëron zvogëlimin e dioksidit të karbonit dhe emetimeve të ngjashme nga nafta, qymyri dhe natyra termocentrale me gaz.

Duke iu referuar analizave të ndryshme të realizuara në lidhje me politikën mbi ndryshimet klimatike të Administratës së Trump, është krahasuar më tepër për ngjashmëritë me atë të George W. Bush duke iu referuar skepticizmit që të dy këto presidentë patën mbi pasojat e ndryshimeve klimatike. Gjithashtu ato i vlerësuan dhe anuluan disa rregullore apo traktate të nënshkruara me justifikimin se ishin në disavantazh të SHBA-ve dhe se ishte Kina shteti që përfitonte duke kufizuar emetimet e gazrave serë të emetuara nga industria në Kombet e Bashkuara.

3. Politikën në nivel rajonal dhe lokal dhe rëndësia e tyre

Një nivel tjetër i qeverisjes gjithashtu luan një rol qendror në politikën e ndryshimit të klimës: qeveria rajonale. Termi 'rajon' përcaktohet në kuptimin se çdo formë e qeverisjes lokale pikërisht mbi qeveritë lokale ose bashkitë. Sigurisht që duhet të merret në konsideratë rëndësia e institucioneve të tilla dhe veprimet vendimtare që duhet të ndërmarrin. Afërsia e tyre me qytetarët, fleksibiliteti i tyre më i madh se qeveritë kombëtare dhe fakti që ata janë përgjegjës për shumë nga fushat e politikave të përfshira në politikën klimatike (energji, transporti, industria, strehimi, mjedisi, etj.) tregojnë rëndësinë e qeverive rajonale në diskutimet mbi politikën klimatike. Por duhet të pranohet se disa probleme mund të lindin gjithashtu nga bashkëveprimi dhe përpjekjet shtetërore dhe ato rajonale, në varësi të natyrës së mbivendosjes së politikës (Goulder et.al, 2010).

Rëndësia e politikave rajonale dhe atyre lokale qëndron në disa pika kryesore, të cilat në harmoni me njëra-tjetrën bëjnë të mundur zbatimin e duhur dhe sigurojnë efikasitetin e kërkuar. Zbatimi i vendimeve lokale ndodh ashtu siç është parashikuar në bazë të vendit ose ligjit rajonal. Për më tepër, politikën rajonale veprojnë në mënyrë autonome. Disa nga përgjegjësitë kryesore të institucioneve qeverisëse rajonale janë identifikimi i përparësive rajonale dhe vendosja e theksit tek përmirësimi rajonal në aspektin e bashkëpunimit me aktorët lokalë.

Nënçështjet në vijim paraqesin në mënyrë të përmbledhur planet strategjike dhe aktet ligjore të hartuara dhe të zbatuara lidhur me ndryshimet klimatike. Përshkrimet e politikave së bashku me

rëndësinë e secilës prej tyre na japin një kuptim më të detajuar për politikat më kryesore duke veçuar rastet e qeverisjes rajonale të Arizonës, Kalifornisë dhe Nju Jork-ut.

3.1. Arizona

Ndonëse, Arizona ishte një prej shtetet udhëheqëse në politikën e klimës 15 vjet më parë, shumë politika që duhen zbatuar me shpejtësi duket se kanë ndaluar duke rrezikuar përkeqësimin e klimës së shtetit dhe qëndrueshmërinë e jetesës. Rasti i ndotjes së shtuar në Kanionin e Madh shkaktuar nga ndotja nga automjetet, termocentralet me qymyr dhe djegiet e pakontrolluara përbënte një shqetësim të veçantë për Arizonën. Në atë kohë, Arizona mori shtysë nga ky problem dhe udhëhoqi përpjekjet për reduktimin e ndotjes, duke nisur partneritete me shtetet e tjera perëndimore dhe duke nxitur politikat rajonale që përmirësuan shumë vizibilitetin në Kanionin e Madh dhe ndotjen në të gjithë vendin. Në fillim të viteve 2000, partneriteti i shteteve perëndimore u përdor për të adresuar një fenomen tjetër që sapo kishte nxitur ndërgjegjen rajonale, atë të ndryshimit të klimës. Shqetësimet në rritje në lidhje me emetimet e gazeve serë dhe ndikimin e tyre çuan Arizonën të zhvillonte një plan veprimi gjithëpërfshirës për klimën e shtetit. Shtete të tjera ndoqën veprimet e Arizonës.

Gjatë zhvillimit të planit të vitit 2006, Arizona zbuloi se sektorët e transportit dhe energjisë elektrike përbënin gati 40% secili prej emetimeve totale të shtetit. Qytetet ishin në një luftë me ndotjen e përkeqësuar të ajrit, me shkak kryesor emetimet nga djegia e karburanteve të automjeteve. Në atë kohë, u përcaktua se miratimi i standardeve më të rrepta të California Clean Car ishte i domosdoshëm, veçanërisht në lidhje me rritjen e shpejtë të popullsisë të Arizonës ashtu edhe në përdorimin e shtuar të automjeteve. Më pas në vitin 2010 shteti nënshkroi një urdhër ekzekutiv për të tërhequr Arizonën nga Iniciativa e Klimës Perëndimore, duke akuzuar se programi do të dëmtojte ekonominë e shtetit. Dy muaj më vonë, u nënshkrua një ligj që ndalonte çdo agjensi shtetërore të monitorojë edhe emetimet e gazeve serë. Ligji mbetet ende sot.

Zhvillime të tjera me rëndësi renditen por jo në favor të klimës së Arizonës. Në një goditje të fundit në momentin e epokës së qeverisjes së Napolitano, Brewer nënshkroi një urdhër që, në 2012, bllokoi shtetin nga miratimi i standardeve të makinave të pastra. Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë e Arizonës e pa këtë si justifikim nga "mjedisi rregullator mbizotërues" i Kalifornisë. Ambientalistët e dënuan këtë veprim. Nënshkrimi i Brewer i SB 1070, një ligj anti-imigracion, e zhyti Arizonën në kaos politik dhe e futi shtetin në qendër të vëmendjes së vendit. Rritja e polarizimit politik në të gjithë vendin e shtyu çështjen e ndryshimit të klimës mënjandë dhe e bëri atë gjithnjë e më shumë një çështje partiake.

Gjatë viteve të qeverisjes së G.W.Bush, John McCain ka qenë i vetmi senator republikan që bëri presion për legjislacionin e ndryshimit të klimës, por pas humbjes së tij elektorale në 2008, ai u kthye në vijën e partisë dhe luajti një rol të madh në bllokimin e çdo legjislacioni për klimën.

Që nga ajo kohë, nuk ka pasur asnjë veprim gjithëpërfshirës për klimën nga guvernatori apo legjislatura. Me shfuqizimin nga Administrata Trump të standardeve të makinave të pastra të miratuara nga qeverisja Obama, megjithë konstatimet e Agjencisë së Mbrojtjes së Mjedisit rievokimi i kësaj politike mund të çojë në rritje të vdekjeve të parakohshme nga rritja e ndotjes së

ajrit, duke qenë se dhe qeveria rajonale ka krijuar një prapavijë edhe më të ulët për luftën ndaj ndotjes së ajrit.

Aktualisht efektet e ndryshimit të klimës në Arizona janë shumë të theksuara, të tilla përmenden: pakësimi i borës dhe thatësira ekstreme që po shterojnë furnizimet me ujë të lumit Kolorado, temperaturat e verës po rriten çdo vit e më shumë ashtu dhe vdekjet e lidhura me nxehtësinë. Në vitet e fundit, guvernatori dhe Legjislatura nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim lidhur me situatën aktuale përkeqësuese, duke miratuar ligje që ndalojnë përpjekjet zbutëse në një nivel lokal. Një ligj tjetër në Arizona madje parandalon agjencitë shtetërore të monitorojnë gazrat serë.

Si përfundim, kuptojmë se duke marrë në konsideratë ndikimin që ndryshimi i klimës do të ketë në vazhdim në ekonominë e Arizonës, udhëheqësit e shtetit duhet të mbështesin përpjekjet rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare për të ulur emetimet e gazeve serë së bashku me masat specifike për Arizonën. Arizona ka kushte të favorshme të përfitojë ndjeshëm nga një kalim në energjinë e pastër të ripërtëritshme. Potenciali i tij diellor është më i miri në vend. Arizona mund të bëhet një udhëheqës botëror në teknologjinë diellore, duke gjeneruar dhjetëra mijëra punë me pagë të lartë dhe miliarda dollarë fitime eksporti përtej kufijve. Laboratori Kombëtar i Energjisë së Rinovueshme ka vlerësuar që Arizona ka potencialin të gjenerojë 5.8 gigavat orë energji elektrike, më shumë se në çdo shtet tjetër në SHBA. Ende ky potencial nuk është përdorur. Ekzistojnë tashmë stimuj të nivelit kombëtar, shtetëror dhe të shërbimeve për të përdorur këtë potencial të madh, duke përfshirë Standardin e Portofolit të Rinovueshëm të Arizonës, i cili mandaton një pjesë prej 15 përqind të gjenerimit të rinovueshëm deri në vitin 2025.

Një stimul kryesor për zhvillimin e shpejtë të tranzicionit në energji të pastër do të ishte një politikë rajonale që përcakton një çmim në emetimet e karbonit përmes një tarifë emetimi ose një regjimi të kufizuar të tregtisë së aplikuar në sektorin e shërbimeve të energjisë elektrike. Një politikë e tillë do të barazonte strukturën e kostos në mënyrë që energjia diellore të mund të konkurronte ekonomikisht në tregjet ndër-shtetërore dhe rajonale me avantazhet e kostove të qëndrueshme operative dhe potencialin e madh të energjisë diellore. Është në interesin ekonomik, shëndetësor dhe mjedisor të Arizonës të mbështesë politikat kombëtare dhe rajonale të këtij lloji për të ulur impaktin negativ nga menaxhimi i keq dhe jo i përshtatshëm i situatës së klimës në Arizona.

3.2. Kalifornia

Rajoni i Kalifornisë, renditur si ekonomia e gjashtë më e madhe në botë, është parë prej kohësh si pioniere në çështjet mjedisore në lidhje me ngrohjen globale. Qasja e saj për ndërmarrjen e politikave ndaj ndryshimeve klimatike karakterizohet nga përpjekje të vazhdueshme për të përfshirë më shumë elementë strukturorë në qëllimet e adaptimit dhe nga vazhdimësi e këtyre politikave të shtetit për zgjerim të mëtejshëm të tyre mbështetur në vlerësimet e vazhdueshme të çështjes përmes Akteve Normative të Ndryshimit të Klimës në Kaliforni. Politikat e ndërmarra tërheqin vëmendjen e studiuesve dhe vlerësuesve pasi kanë në thelb disa parime kryesore me qëllim vlerësimin e politikave duke u përqendruar në ndryshimin e klimës. Pikërisht përmbajtja e elementëve kryesore, si: integrimi, qasja e lidhur me ndryshimet klimatike në hartimin e politikave të sektorëve të tjerë,

marrja parasysh e perspektivës së popullsisë dhe koordinimi i autoriteteve të qeverisjes rajonale me ato kombëtare me fokus shëndetin publik, e bëjnë shembullin e Kalifornisë mjaft influencues.

Hapi i parë i Kalifornisë drejt përgatitjes për ndikimet e ndryshimit të klimës nis me politikën e adaptimi në vitin 2002, me miratimin e projekt-ligjit AB 1493, që guvernatori Gray Davis ndërmori për të zhvilluar standarde për të arritur zvogëlimin maksimal të mundshëm dhe kosto-efektiv të gazeve serë nga automjetet.

Më tej, në qershor 2005, Guvernatori Arnold Schwarzenegger nënshkroi një urdhër ekzekutiv që bën thirrje për reduktime të emetimeve të gazeve serrë: 11 % deri në 2010, 25% deri në 2020 dhe 80% deri në 2050. Masat për të përmbushur këto objektiva përfshinë standarde më specifike të emetimeve nga automjetet.

Në 30 gusht 2006, Schwarzenegger dhe Legjislatura e Kalifornisë arritën një marrëveshje mbi AB32, Aktin e Zgjidhjeve të Ngrohjes Globale. Projekt-ligji u nënshkrua në ligj në 27 shtator 2006, nga Arnold Schwarzenegger, i cili deklaroi, *"Ne thjesht duhet të bëjmë gjithçka që mundemi për të ngadalësuar ngrohjen globale para se të jetë tepër vonë..."*. Akti krijon një sistem të detyrueshëm të raportimit të emetimeve. Kjo marrëveshje përfaqëson programin e parë të zbatueshëm në SHBA për të mbuluar të gjitha emetimet nga industritë kryesore, që përfshin ndëshkime në moszbatim. Kjo politikë gjithashtu mundësoi lejimin e mekanizmave të tregut për të siguruar stimuj për bizneset që të zvogëlojnë emetimet, në të njëjtën kohë duke mbrojtur komunitetet lokale.

Për më tepër, më 26 Shtator Guvernatori Schwarzenegger nënshkroi SB 107, i cili kërkoi që tre ndërmarrjet kryesore më të mëdha të Kalifornisë - Pacific Gas & Electric, Southern California Edison dhe San Diego Gas & Electric - deri në vitin 2010 të prodhonin 20% të energjisë elektrike duke përdorur burime të rinovueshme. Kjo nismë shkurtoi harkun kohor të miratuar fillimisht nga guvernatori Davis në fillim të vitit 2002, për të rritur shitjet e energjisë së rinovueshme të shërbimeve 1% në vit në 20% deri në 2017.

Guvernatori Schwarzenegger gjithashtu ka bërë përparime të mëtejshme pavarësisht nga qeveria federale, lidhur me përpjekje të ndryshme ndërkombëtare për të adresuar ngrohjen globale. Një nga këto është përpjekja për bashkëpunim me Kryeministrin Toni Bler të Britanisë së Madhe.

Në vazhdim në vitin 2018, guvernatori Jerry Brown lëshoi një urdhër ekzekutiv duke bërë thirrje që Kalifornia të bëhej neutrale deri në vitin 2045 dhe Guvernatori Newsom nënshkroi një urdhër ekzekutiv në 2019 për të shfrytëzuar 700 miliardë dollarë në investime për të rritur qëndrueshmërinë e klimës. Përpjekjet e Kalifornisë për të zvogëluar emetimet e gazeve serë kanë sjellë shtetin në konflikt me qeverinë federale. Shteti i Kalifornisë ka kundërshtuar disa rregullore federale të lidhura me klimën, pasi Kalifornia është përpjekur gjithashtu të bllokojë iniciativat shtetërore dhe është përpjekur të tërheqë Shtetet e Bashkuara nga Marrëveshja e Klimës së Parisit.

³Referuar raportit të vitit 2020 të publikuar nga Instituti i Politikave Publike të Kalifornisë, Kalifornia po përdor një qasje shumëplanëshe për të ulur emetimet. Bordi i Burimeve Ajrore të Kalifornisë (CARB), i cili është përgjegjës për zbatimin e Ligjit të Zgjidhjeve ndaj Ngrohjes Globale, raportoi në 2017 që emetimet e shtetit ishin tashmë nën objektivin e vitit 2020. Ky bord ka

³ Hanak, E. Gray, B. Mount, J. (Janar 2020): Raporti nga PPIC California's Future: Climate Change. <https://www.ppic.org/wp-content/uploads/californias-future-climate-change-january-2020.pdf>

krijuar një kornizë për përmbushjen e objektivit të emetimeve të vitit 2030, e cila do të kërkojë përpjekje të reja të rëndësishme.

Përpjekje të tjera me synim arritjen e qëllimeve të vitit 2030 janë ndërmarrë nga shteti i Kalifornisë dhe në sektorin e energjisë. Kalifornia është e përkushtuar të sigurojë të gjithë energjinë elektrike nga burimet e rinovueshme dhe pa karbon deri në vitin 2045 dhe ka rritur objektivin e saj në 2030 për energjinë e rinovueshme në 60 përqind. Shteti e përmbushi qëllimin e tij të vitit 2020 për të siguruar një të tretën e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme përpara afatit, nga të dhënat 34 përqind e shitjeve me pakicë të energjisë elektrike u siguruan nga burimet e rinovueshme në 2018.

Brenda kornizës së veprimeve dhe planeve për uljen e impakteve të pashmangshme të ndryshimeve klimatike, me shumë rëndësi vlerësohet program i nivelit mbarëkombëtar të tregtisë duke sjellë fleksibilitet në uljen e emetimeve. Kalifornia është shteti i parë që miratoi një program të mbulimit dhe tregtisë së emetimeve të karbonit në atmosferë. Duke lejuar bizneset të tregtojnë lejet e emetimeve, tregtia e lirë lejon forcat e tregut të ndihmojnë në përcaktimin e kostos së zvogëlimit të emetimeve. Ankandet e lejeve filluan në 2012 me ndërmarrjet elektrike dhe emetuesit e mëdhenj industrialë; transporti dhe karburantet e ngrohjes u shtuan në 2015. Ankandet tanimë mbulojnë 85% të emetimeve GHG të shtetit.

Politikat e reja kanë në fokus eliminimin e metanit dhe lëndë të tjera të dëmshme. Ndotësit e atmosferës, si: metani, karboni i zi dhe gazrat e fluorizuar, janë gazra të fuqishëm që ngrohin klimën si dhe dëmtojnë cilësinë e ajrit. Projekt-ligji SB 1383, miratuar në 2016, mandatoi eliminimin e metanit dhe hidrofluorokarbureve me 40 përqind dhe karbonit të zi me 50 përqind në nivelet e vitit 2013 deri në vitin 2030, sipas një strategjie të propozuar nga CARB (Bordi i Burimeve Ajrore të Kalifornisë).

Një plan tjetër ndihmës dhe mjaft strategjik përfshin tokat natyrore për thithjen dhe ruajtjen e karbonit të dëmshëm. Më shumë se 90 përqind e shtetit është e mbuluar nga toka natyrore ose të punës si pyje, toka bujqësore, kullota dhe hapësira të gjelbërta urbane. Shteti ka hartuar "*Planin e Zbatimit të Ndryshimeve Klimatike të Tokave Natyrore Kalifornia 2030*" për të ruajtur, rivendosur dhe menaxhuar këto toka si absorbues të karbonit, duke e ruajtur atë në bimësi. Kjo do të sjellë përfitime, siç janë përmirësimi i cilësisë së ajrit dhe ujit dhe mundësitë rekreative.

Me të vërtetë, Kalifornia ka qenë shteti i parë, i cili ka arritur të adresojë efektet e ndryshimit të klimës nëpërmjet hartimit dhe zbatimit efektiv të një sërë politikash ashtu si dhe përmenden më lart. Edhe pse efektet e ndryshimit të klimës janë tashmë të dukshme dhe mund të përkeqësohen me kalimin e kohës, arrijmë të kuptojmë se Kalifornia është përpara shteteve të tjera.

3.3. New York

Me nisjen e politikës më kryesore ndryshe të njohur si Reformimi i Vizionit të Energjisë (REV) në vitin 2014, nën qeverisjen e Guvernatorit Andrew M. Cuomo, fokusi vihet në sigurimin e një rrjeti të integruar të energjisë në gjendje të shfrytëzoshme përfitimet e kombinuara të rrjetit qendror me energji të pastër, të prodhuar në vend. Ky plan me synim nxitjen e prosperitetit ekonomik dhe administrimin e ndotjes së mjedisit në Nju Jork, ka synim të bëjë të mundur bashkëpunimin midis

qeverisë dhe industrisë përmes partneritetit publik-privat për arritjen e qëllimit të përbashkët për një ekonomi më të shëndetshme dhe më të fortë të Nju Jorkut. Plani Shtetëror i Energjisë është gjithëpërfshirës për të ndërtuar një sistem energjie të pastër si dhe koordinon çdo agjenci shtetërore dhe autoritet që prek energjinë për të çuar përpara zbatimin e reformës, duke ridizenjuar programe për të zhbllokuar kapitalin privat dhe duke gjetur zgjidhje inovative të energjisë. Autoriteti i Kërkimit dhe Zhvillimit të Energjisë së Shtetit të New York-ut ofron stimuj në formën e granteve dhe huave për banorët e tij për të adoptuar teknologji të energjisë së rinovueshme dhe për të krijuar biznese të energjisë së rinovueshme.

Një nga pengesat kryesore për arritjen e qëllimit kryesor, pra atij të reduktimit të emetimeve në atmosferë, është transferimi drastik i burimit të energjisë. Deri në vitin 2030, synohet të merret 70% e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme dhe deri në 2040 qëllimi është që e gjithë energjia elektrike e shtetit të sigurohet nga burime pa karbon si: energjia e erës dhe diellit. Disa ofrues të shërbimeve të energjisë pretendojnë se ky qëllim është shumë ambicioz dhe do të rezultojë në fatura më të larta për qytetarët.

Sektorë të tjerë gjithashtu do të duhet të përshtaten për të arritur këto objektiva të reduktimeve të emetimeve. Transporti përbën një të tretën e emetimeve të shtetit, por standardet kombëtare të reduktimeve të emetimeve po rikthehen për të lejuar më pak ndotje dhe standarde më të rrepta shtetërore për uljen e emetimeve të transportit, të cilat gjatë vitit 2020 janë kundërshtuar nga administrata Trump.

Ndër zhvillimet më të fundit në legjislacionin lidhur me ndryshimet klimatike është shtimi i Ligjit për Menaxhimin e Klimës dhe Mbrojtjen e Komunitetit, që do të implementojë disa nga qëllimet më ambicioze të vendit për të luftuar ndryshimin e klimës në aspektin ligjor, duke kërkuar që shteti të shkurtojë 85% të emetimeve të tij të gazrave serë (nga nivelet e vitit 1990) deri në vitin 2050 dhe të miratojë projekte të gjelbërta. Sipas studiuesve të ndryshimeve të klimës dhe ambientalistëve ky është një hap i guximshëm për të luftuar kundër ndryshimit të klimës.

Ndërveprimi i suksesshëm i kompanive, zhvilluesve të politikave të mëtejshme, agjencive rajonale dhe atyre qeveritare, konsumatorëve do të jetë thelbësor për të përmbushur objektivat e përcaktuara të energjisë së pastër.

4. Përfundime dhe referenca

4.1. Përfundime

Ndryshimi i vërejtur i klimës dhe pritjet e ndryshimit të ardhshëm po ndikojnë rrjedhën e strategjive të zhvillimit, ku të dyja si agjencitë e zhvillimit edhe qeveritë tani po planifikojnë për këtë sfidë përshtatjeje. Prandaj, sfida kryesore e paraqitur si në shkallën e menaxhimit të burimeve natyrore lokale ashtu edhe në shkallën e marrëveshjeve dhe veprimeve ndërkombëtare, është promovimi i kapacitetit të përshtatshëm në kontekstin e objektivave konkurruese të zhvillimit të qëndrueshëm. Qëllimi është të zvogëlohet cënueshmëria ndaj efekteve të dëmshme të ndryshimit të klimës (si rritja e nivelit të detit, ngjarjet më ekstreme të motit ose pasiguria ushqimore), duke përfshirë

shfrytëzimin në maksimum të mundësive të dobishme që lidhen me ndryshimin e klimës (për shembull, sezone më të gjata të rritjes ose rritje të rendimenteve në disa rajone). Prej vitesh qeveria amerikane ka qenë e vetëdijshme se efektet e krijuara nga klima në komunitet mund të krijojnë mungesë sigurie ose të fillojnë konflikte që kërkojnë ndërhyrje të forcave përkatëse, përfshirë humbjen e jetës dhe pronës, dëmtimin ose shkatërrimin e infrastrukturës, degradimin e shërbimeve njerëzore (p.sh. uji i pijshëm, trajtimi i ujërave të zeza) dhe migrimin masiv.

Nga rishikimi dhe analizimi i informacioneve mbi qeverisjen rajonale mund të arrijmë në disa përfundime lidhur me adresimin e çështjes së ndryshimeve klimatike të shteteve të shqyrtuara në këtë detyrë. Analizimi i politikës së ndjekur në shtetin e Arizonës na bën të kuptojmë se edhe pse Arizona renditej si një nga shtetet e para në nisjen e adresimit të trajtimit të ndikimit të ndryshimeve klimatike të theksuara, neglizhenca e politikbërësve nuk i vjen aspak në ndihmë klimës duke ndikuar drejtpërdrejtë negativisht në shëndetin e njerëzve. Gjithashtu, politikat rajonale që përdorin potencialin e madh të burimeve natyrore të ripërtëritshme mund të jenë një nga shembujt se si identifikimi i përparësive rajonale lejon zhvillimin më të mirë ekonomik të shtetit ndërkohë që shteti “shpëtohet” nga përkeqësimi i ndotjes duke kaluar në përdorim të energjisë së rinovueshme dhe të pastër në favor të ruajtjes së mjedisit.

Duke pasur parasysh rastin e Kalifornisë, dalim në përfundimin se përditësimi i vazhdueshëm i politikave mbi ndryshimet e klimës si dhe ndërmarrja e politikave që mundësojnë lejimin e mekanizmave të tregut për të siguruar stimuj për bizneset që të zvogëlojnë emetimet, në të njëjtën kohë duke mbrojtur komunitetet lokale janë politika që sugjerohen. Arritja e objektivave brenda vitit 2020 në lidhje me reduktimin e emetimeve, vërteton suksesin e shtetit në uljen e efekteve të ndryshimit të klimës nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të një sërë politikash efektive.

Politikat e nisura në Nju Jork kanë gjithashtu synimin për të reduktuar emetimet e gazrave të dëmshëm nga sektori i transportit. Megjithatë, nëpërmjet analizimit të informacionit për këtë shtet, kuptojmë më shumë për vështirësitë që paraqesin vendet e mëdha urbane dhe kërcënimin në zbatimin jo të suksesshëm e pengues të politikave, që sjellin fenomenet si: rritja e vazhdueshme të popullsisë dhe përdorimi i shtuar të mjeteve transportuese.

Nga analiza e mësipërme konkludojmë se politika e Klinton ndoqi hapat e paraardhësit duke zgjeruar në kontekstin pozitiv disa prej pikave të planit të tij. Më tej mund të themi se presidenti i fundit i Amerikës, Trump, së bashku me George Bush janë etiketuar vazhdimisht për neglizhencën e treguar në lidhje me politikat e ideuara kundrejt ndryshimeve klimatike të cilat në kohën e qeverisjes së tyre, sollën efektet më shkatërruese në mjedis. Ata u përqëndruan në rritjen e biznesit, duke marrë parasysh në këtë pikë rivalitetin me gjigandin e teknologjisë e inovacionit, Kinën. Si përfundim, theksojmë se politika e Obamës mbetet më e mira prej katër politikave të analizuara më sipër, ishte ajo e cila dha efektet më pozitive dhe më miqësore ndaj mjedisit.

Si përfundim, për të përmbushur objektivat e përcaktuara të politikave është i nevojshëm bashkëpunimi i kompanive, zhvilluesve të politikave të mëtejshme, qeverisjeve rajonale me atë kombëtare.

4.2. Bibliografia

1. Pavone R. (2017) "The Paris Agreement and the Trump administration: Road to nowhere?"
https://www.jois.eu/files/3_315_Pavone.pdf
2. White House (2015) "President Obama's climate action plan"
https://obamawhitehouse.archives.gov/sites/default/files/docs/cap_progress_report_final_w_cover.pdf
3. Galarraga, I., Gonzalez-Eguino, M., & Markandya, A. (2011). *The Role of Regional Governments in Climate Change Policy. Environmental Policy and Governance.*
4. Repetto, R. (2011). *Economic and Environmental Impacts Of Climate Change In Arizona.*
5. Arizona Dept. of Tourism, 2011, Arizona Tourism in 2010, Arizona Governor's Conference on Tourism, July 14, 2011.
6. Ackerman, Frank, Stanton, E., 2011, "The Last Drop: Climate Change and the Southwest Water Crisis," Stockholm Environmental Institute, Somerville, MA.
7. Department of Energy, Report to Congress: Assessment of Potential Impact of Concentrating Solar Power for Electricity Generation www.nrel.gov/csp/troughnet/pdfs/41233.pdf.
8. Department of Energy, States with Renewable Portfolio Standards,
http://apps1.eere.energy.gov/states/maps/renewable_portfolio_states.cfm.
9. Climate Change in New York State Updating the 2011 ClimAID Climate Risk Information Supplement to NYSERDA Report (Responding to Climate Change in New York State) Final Report.
10. Hallegatte, S., & Corfee-Morlot, J. (2010). Understanding climate change impacts, vulnerability and adaptation at city scale: an introduction. *Climatic Change*, 104(1), 1–12.
11. "Governor Cuomo Executes the Nation's Largest Offshore Wind Agreement and Signs Historic Climate Leadership and Community Protection Act".
12. K.L.M. Lewis; T.K. Maycock; B.C. Stewart. "Impacts, Risks, and Adaptation in the United States: Fourth National Climate Assessment", Volume II (Report). Washington, DC, USA: U.S. Global Change Research Program. National Climate Assessment covers Arizona, California, Colorado, New Mexico, Nevada, and Utah. <https://nca2018.globalchange.gov/chapter/25/>

Websitet e vizituara për marrjen e informacionit renditen si më poshtë:

1. https://ballotpedia.org/Trump_administration_officials_on_energy_and_the_environment
<https://www.eesi.org/papers/view/fact-sheet-timeline-progress-of-president-obama-climate-action-plan>
<https://www.adaptationclearinghouse.org/resources/climate-change-resilience-strategies-for-buildings-in-new-york-state.html>
<https://www.nyserderda.ny.gov/About/Publications/Research%20and%20Development%20Technical%20Reports/Environmental%20Research%20and%20Development%20Technical%20Reports/Response%20to%20Climate%20Change%20in%20New%20York>
2. <https://energywatch-inc.com/clean-energy-and-the-climate-leadership-and-community-protection-act-where-is-ny-one-year-later/>
3. https://media.rff.org/documents/Climate_Insights_2020_Policies_and_Politics.pdf
4. https://en.wikipedia.org/wiki/Climate_change_policy_of_California